



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 117, datë 06.06.2019

**PËR
MARRJEN E MASAVE KORRIGJUESE, NDAJ VLERËSUESIT TË DËMEVE NË
SIGURIME Z. HAJRI GËRBI**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 2) dhe pikës 21), të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 235 dhe nenit 152 pika 1, germa a) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

BSHS, me shkresën nr. 1192 prot., datë 18.02.2019, ka depozituar në Autoritet disa akte vlerësimi të hartuar nga ky vlerësues dëmsh, me kërkesën për rishikimin e tyre nga Autoriteti për shkak se janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Z. Hajri Gërbi, vlerësues i pavarur i dëmeve në sigurime, licencuar me nr. 151 datë 20.10.2017, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, gjatë veprimtarisë si vlerësues dëmsh në sigurime ka kryer akt vlerësim dëmi në disa variante për një ngjarje sigurimi.

Nga verifikimi i akteve të vlerësimit konstatohet se:

Vlerësimi për dëmin moral dhe ekzistencial për rastin me paaftësi të përhershme të z. Sajmir Kastrati është llogaritur në kundërshtim me përcaktimet e Rregullores nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar.

Këto figura dëmi janë llogaritur të ndara, ku vlera respektive për secilën figurë është konsideruar vlera që i takonte sipas rregullores të dyja figurave së bashku (moral dhe ekzistencial). Gjithashtu këtyre vlerave i është shtuar 1/3 e dëmit për secilin pjesëtar të familjes.

Në takimin e organizuar pranë zyrave të AMF-së, në datën 19.03.2019, midis përfaqësuesve të Drejtorisë së Zbatueshmërisë dhe vlerësuesit të pavarur z. Hajri Gërbi, nga ana e këtij të fundit është pretenduar se përlllogaritja e dëmit moral dhe ekzistencial si figura të ndara më vete, janë kryer me kërkesën e miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor.

Po kështu, shoqëria e sigurimit “Intersig” sh.a. me shkresën nr. 510 prot., datë 18.03.2019, është ankuar në lidhje me përlllogaritjen e vlerësimit të demit shëndetësor me paaftësi të përhershme që i përket z. Adnand Hoxha, etj.

Edhe për këtë rast, Autoriteti, i ka dërguar shkresë vlerësuesit të pavarur z. Hajri Gërbi, duke e informuar rreth pretendimeve të shoqërisë “Intersig” sh.a. dhe duke i caktuar takim pranë zyrave të AMF-së, në datën 29.03.2019, ora 11:00, për t’u dëgjuar në lidhje me çdo sqarim apo observacion lidhur me këtë konstatim (nuk është paraqitur), por pretendimet e tij i ka parashtruar me shkresën e regjistruar në AMF nr. 984/2 datë 24.04.2019.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në nenin 152, pika 1) germa a) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, urdhërohet vlerësuesi i pavarur z. Hajri Gërbi, si më poshtë:
 - i. Të kryejë veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime në përputhje me legjislacionin në fuqi në sigurime;
 - ii. Të bëjë vlerësime të paanshme duke respektuar parimin një vlerësim për një ngjarje sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 233, të Ligjit nr. 52/2014.
2. Përsëritja e shkeljeve të mësipërme, do të jetë objekt i masave të përshkallëzuara konform legjislacionit në fuqi.
3. Ngarkohen Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë për njoftimet dhe ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI